



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**FONDI I SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR
DREJTORIA E PËRGJITHSHME**



Nr. 2181 Prot.

Tiranë, më 12.03.2020

U D H Ë Z I M

Nr. 04, Datë 12 / 03 / 2020

**“MBI KUFIZIMIN E LËVIZJES SË PACIENTËVE NË SISTEMIN SHËNDETËSOR
PUBLIK PARËSOR”**

Në zbatim të ligjit nr. 10383, datë 24.02.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; Urdhrit të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me Nr. 159, Datë 11.03.2020 “Për kufizimin e lëvizjes së pacientëve, shoqëruarve dhe/ose familjarëve dhe organizimin e shërbimeve në institucionet e kujdesit shëndetësor ku kryhen vizita dhe konsulta ambulatore”; Kontratës me dhënësit e shërbimeve në kujdesin shëndetësor parësor për Vitin 2020, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infekzioni i shkaktuar nga Virusi COVID-19,

U D H Ë Z O J :

1. Të gjithë dhënësit e shërbimit shëndetësor publik parësor të marrin masat e nevojshme me qëllim minimizimin e prezencës së pacientëve në institucionet shëndetësore publike (Qendra Shëndetësore apo Spitäte) dhe evitimin e grumbullimeve të tyre, përgjatë kohës së rrezikut nga epidemja e shkaktuar nga Virusi COVID-19.
2. Të gjithë mjekët e përgjithshëm / mjekët e familjes duhet të evidentojnë pacientët kronikë të cilët trajtohen me receta periodike me rimbursim sipas datave përkatëse.
3. Në të gjitha rastet e mundshme, mjeku duhet të kontaktojë me telefon me këta pacientë (ose me familjarë të tyre) dhe në rastet kur e gjuxon që pacienti është i stabilizuar me mjekimin aktual, ta udhëzojë pacentin që të mos paraqitet në ambientet e Qendrës Shëndetësore.
4. Mjeku më pas gjeneron recetën/recetat përkatëse në sistemin e recetës elektronike, i komunikon pacientit (me telefon, sms apo mënyra të tjera elektronike) Kodin/Kodet e recetës, me të cilat pacienti të paraqitet direkt në farmaci për të tjerhequr barnat.

5. Të gjitha këto raste do të evidentohen si vizita në dokumentacionin përkatës si rregjistri i vizitave, kartela personale e pacientit, formulari i vizitës dhe procedurës, etj..
6. Gjatë këtij procesi, nga ana e mjekëve të mbahet në vëmendje mundësia e lëshimit të recetave për periudha 6 Mujore (pra 3 receta 2 Mujore).
7. Në rastet e patologjive akute, patologjive të reja kronike apo kur mjeku gjykon që gjendja shëndetësore e pacientit nuk është e stabilizuar, dhe bëhet e domosdoshme vizita i pacientit nga afër, atëherë mjeku realizon vizitën normale të pacientit, sipas rastit pranë Qendrës Shëndetësore ose pranë banesës së këtij të fundit.
8. Gjithashtu referimi i patientëve për konsulta specialistike apo egzaminime të ndryshme si nga mjekët e përgjithshëm / mjekët e familjes drejt Poliklinikave përkatëse të Specialiteteve, ashtu edhe nga Qendrat Shëndetësore të Specializuara në Tiranë drejt Spitaleve Universitare, duhet të evitohen duke referuar vetëm rastet kur konsulta apo egzaminimi është i domosdoshëm për ndjekjen e gjendjes shëndetësore të pacientit.
9. Në funksion të lëshimit të recetave me rimbursim të konsiderohet e vlefshme konsulta e fundit mjekut specialist të Poliklinikës së Specialiteteve apo spitaleve bashkiakë, rajonale apo universitare, pavarësisht periudhës së rikontrollit të përcaktuar në konsultë apo fletë dalje nga spitali.
10. Në rastet e prezencës së patientëve pranë institucioneve shëndetësore publike duhet të respektohet në mënyrë rigorozë perimetri i sigurisë dhe distanca midis patientëve dhe ofruesve të shërbimit të jetë jo më pak se 1.5 metër distancë nga njëri-tjetri.
11. Në të gjitha rastet e mësipërme trajtimi i patientëve do të bëhet në zbatim të protokolleve të përdorimit të barnave, kufizimeve të Listës së Barnave të Rimbursueshme dhe akteve të tjera në fuqi.
12. Ngarkohen Drejtoritë Rajonale / Degët e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, të cilët në koordinim me Drejtoritë Rajonale / Njësitë Vendore të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor të marrin të gjitha masat për zbatimin e këtij Udhëzimi dhe njoftimin e të gjithë dhënësve të shërbimit shëndetësor publik parësor të kontraktuar nga ana e tyre.
13. Ky Udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Rudina Degjoni

